

001-1195/3000  
07/10/2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM

Nr. 22 Datë 07/10/2024

MIRATIMI I PROJKETIT "UNIVALENS"

Bordi i Administrimit i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 126, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 80/2015, për "Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit vjetor Nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", Udhëzimit të Ministrit të Financave, Nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i Projekteve në Universitetin e Arteve, pas diskutimeve dhe me votim të hapur,

VENDOSI

1. Miratimin e projektit "Univalens" (*projekti bashkangjitur vendimit*).
2. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Lavdrim SAHITAJ (Kryetar)

Ergis SEFA (Anëtar)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Prof. Asoc. Dr. Sokol SARAÇI (Anëtar)**

**Prof. Besnik BISHA (Anëtar)**

**Jeton SHEHU (Anëtar)**

**Lorenc VANGJELI (Anëtar)**

**Vladimir LLAKAJ (Anëtar)**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORI

Nr. 1195/2 Prot.

Tiranë, më 02.10 2024

Lënda: Përcillen për miratim shkresat e Sektorit të Projekteve, UART

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT,  
UNIVERSITETI I ARTEVE**

*Të nderuar,*

Nëpërmjet kësaj shkrese, në cilësinë e titullarit të Universitetit të Arteve, po ju dërgoj shkresën nr. 1195 prot., datë 20.09.2024 me lëndë "Për nisjen e zbatimit të projektit "UniValens" të mbështetur nga programi Interreg IPA Adriatiku Jugor", me qëllim miratimin e nisjes së zbatimit të projektit UniValens si dhe mundësimin e shpenzimeve, sipas buxhetit të akorduar nga Autoriteti Menaxhues, Rajoni i Pulias.

Për më tepër, përcillet edhe shkresa nr. 1195/1 prot., datë 20.09.2024 me lëndë "Relacion dhe manual për zbatimin e projektit të ndërkombëtarizimit", me qëllim miratimin e manualit për zbatimin e projektit të ndërkombëtarizimit, të përfituar përmes Thirrjes për financimin e IAL-ve publike, publikuar me Urdhrin nr. 360, datë 28.06.2022 të MAS.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI  
SEKTORI I PROJEKTEVE

Nr. 119 Prot.

Tiranë, 20.09.2024

**Lënda: PËR NISJEN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT "UNIVALENS" TË MBËSHTETUR  
NGA PROGRAMI INTERREG IPA ADRIATIKU JUGOR.**

**PROF. DR. ERALD BAKALLI**

**REKTOR**

I nderuar zotë Rektor,

Universiteti i Arteve të Tiranës, ka marrë pjesë dhe është shpallur fitues në kuadër të thirrjes për projekt propozime të Programit Interreg IPA Adriatiku Jugor me Projektin e titulluar: *"Overcoming Cross-border Educational Programs Recognition and Equivalence limitations"* me akronim UniValens" (Tejkalimi i kufizimeve të njohjes dhe ekuivalentimit të programeve ndërkufitare arsimore)

Ky projekt është përfshirë në Objektivin Specifik 1, *"Enhancing efficient public administration by promoting legal and administrative cooperation and cooperation between citizens, civil society actors and institutions, in particular, with a view to resolving legal and other obstacles in border regions"* (Përmirësimi i administrimit efikas publik përmes promovimit të bashkëpunimit ligjor dhe administrative mes qytetarëve, aktorëve të shoqërisë civile dhe, në vecanti institucioneve, me një fokus në zgjidhjen e pengesave ligjore apo të tjera në rajonet kufitare).

Projekti UniValens është një Small Scale Project (Projekt në shkallë të vogël) ku Universiteti i Arteve është partneri leader i projektit, në partneritet me Teatrin Publik Puliez, Universitetin e Malit të Zi, (Fakultetin e Artit Dramatik, si edhe Universitetin e Studimeve "Aldo Moro" Bari, Itali. Ky projekt do të realizohet në një periudhë kohore 12 mujore, brenda datave 01.02.2024 deri në 31.01.2025.





Pas shpalljes fitues, Universiteti i Arteve ka nënshkruar **Marrëveshjen e Financimit** (Subsidy Contract) të projektit UNIVALENS me Autoritetin Menaxhues të Programit si dhe ka nënshkruar me të gjithë partnerët e tij, **Marrëveshjen e Partneritetit**.

Në kuadër të procedurave për mundësimin e zbatimit të skemës së financimit të projektit mes partnerëve dhe për të mundësuar nisjen e procedurave për shpenzimet financiare në Shqipëri, **Universiteti i Arteve** i ka kërkuar dhe i është mundësuar **Hapja e Llogarisë Speciale** të dedikuar të projektit pranë **Bankës së Shtetit Shqiptar**, nga ana e Ministrisë së Financave.

**Fondi i akorduar** për zbatimin e projektit UNIVALENS kap shumën prej 196,998.14 € të ndarë mes 4 partnerëve dhe, ku Universiteti i Arteve financohet me shumën prej 45,838 €, nga të cilat 6,875.70 €, janë bashkëfinancim i vetë institucionit. Kjo shumë menaxhohet sipas rregullave të operacioneve me kosto të thjeshtuara (simplified cost operations) dhe me njësi të caktuara të shpenzimeve si lump sum.

	Partner	Total eligible budget	IPA III co-financing* (%)	IPA III	Total contribution
LP	UART	€ 45.838,00	85%	€ 38.962,30	€ 6.875,70
PP2	TPP	€ 57.586,14	80%	€ 46.068,91	€ 11.517,23
PP3	UoM (FDA)	€ 36.059,00	85%	€ 30.650,15	€ 5.408,85
PP4	UNIBA	€ 57.515,00	80%	€ 46.012,00	€ 11.503,00
Total		€ 196.998,14	82,08 %	€ 161.693,36	€ 35.304,78

\* *Shkalla e financimit të grantit është deri në 80% të kostove të pranueshme për partnerët e territorit Italian dhe, deri në 85% të kostove të pranueshme për partnerët në territorin e Shteteve IPA të Programit (Shqipëria dhe Mali i Zi).*

Sipas përcaktimeve relevante të Thirrjes për Projekt Propozime – Kapitalizim i Projekteve në Shkallë të Vogël dhe në Manualin e Programit, granti i akorduar mund të përdorë Operacione të Thjeshtuara të Kostove për tipologjitë e aktiviteteve të mëposhtme:

- Lump sum për kostot e përgatitjes;
- Lump sum për Workshop, seminare dhe konferenca;
- Lump sum për Misione vizitore;
- Lump Sum për Planin/Modelin/Metodën e Përbashkët të Veprimit

**Aktivitetet, për të cilat është përgjegjës organizativ Universiteti i Arteve janë:**

- Kostot e përgatitjes **5,865 Euro**
- Incoming Mission (Misione vizitore) **16,830 Euro**







- Workshop *13,464 Euro*
- Joint Action Plan (*Planit i veprimit të përbashkët*) *9,679 Euro*

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Partneritetit nga ana e të gjithë Partnerëve, Universitetit të Arteve i lind e drejta të kërkojë një kuotë prefinansimi të projektit në masën 30% të kuotës së mbështetjes IPA, si dhe të kërkojë hapjen e Llogarisë Speciale për zbatimin e projektit në një bankë të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë.

I nderuar zoti Rektor,

Përsa më sipër, kërkohet të merret aprovimi i Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve, për nisjen e zbatimit të projektit UNIVALENS dhe mundësimin e shpenzimeve të përcaktuara sipas buxhetit të akorduar nga Autoriteti Menaxhues, Rajoni i Pulias.

Me respekt

  
Prof. Pjetër Guralumi

Përgjegjës i Sektorit të Projekteve

P.S. Bashkëlidhur gjeni:

- Marrëveshja e Financimit
- Marrëveshja e Partneritetit



